



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7.9.2023

Nr: 764

Ora: 15:30

V E N D I M

P Ë R

PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË PERSONELIT TEKNIK QË MBËSHTET NË TERREN
IMPLEMENTIMIN E IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE NËPËRMJET PEI-T, NË DITËN E
ZGJEDHJEVE, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Në mbështetje të nenit 14, pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Personi i përzgjedhur si personel teknik që mbështet në terren implementimin e identifikimit të zgjedhësve nëpërmjet pajisjes elektronike të identifikimit (PEI) ditën e zgjedhjeve, datë 24 Shtator 2023, përfiton shpërbllim në masën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Efekti financiar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023, për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 7.9.2023 Nr: 764
Ora: 15:30



“Për përcaktimin e masës së shpërbllimit të personelit teknik që mbështet në terren implementimin e identifikimit të zgjedhësve nëpërmjet PEI-t, në ditën e zgjedhjeve, të datës 24 Shtator 2023”.